



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument parlamentar

Tiranë më, 22.10.2018

RAPORT

(Për dhënie mendimi)

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, REPUBLIKËS SË MALIT TË ZI DHE KOMISIONIT EVROPIAN, PËR PROGRAMIN E VEPRIMIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR IPA II, MAL I ZI - SHQIPËRI, ALOKIMET PËR VITIN 2016”

Hyrje

Në bazë të kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës së Komisionit për Politikën e Jashtme, me cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 22.10.2018 shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Evropian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mal i Zi-Shqipëri, alokimet për vitin 2016”, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e komisionit prezantuan projektligjin, Z. Genti Cakja, Zv. Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Znj. Daniela Cekani, Drejtore e Fondeve IPA në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Nisma ligjvënëse

Bazuar në nenin 81 pika 1, neni 100 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ky projektligj vjen me iniciativën ligjvënëse të Këshillit të Ministrave .

Projektligji vjen pas miratimit në parim të marrëveshjes së financimit, me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 798, datë 29.12.2017, “Për miratimin, në parim, të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Evropian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mal I Zi-Shqipëri, alokimet për vitin 2016”.

Baza Kushtetuese e projektligjit

Ky projektligj i paraqitet Kuvendit për miratim në zbatim të neneve 78,83, pika 1 dhe nenit, 121 pika 1 të Kushtetutës.

Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

Qëllimi i projektligjit është ratifikimi i marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Evropian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mal i Zi- Shqipëri, alokimet për vitin 2016.

Programi i bashkëpunimit Mal i Zi - Shqipëri ka për qëllim kryesor të kontribuojë në zhvillimin social-ekonomik të zonave ndërkufitare dhe të rrisë bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve nëpërmjet ndërhyrjeve të përbashkëta.

Programi ka reflektuar rëndësinë që BE-ja i kushton çështjeve horizontale dhe ndërsektoriale, çështje këto të reflektuara përmes përzgjedhjes së prioritetëve të tilla si krijimi i partneriteteve ndërkufitare, “autorësia” vendore dhe mundësitë e barabarta, garantimi i mosdiskriminimit të minoriteteve, mbrojtja e mjedisit, të drejtat gjinore etj. Ky ratifikim mundëson zbatimin e projekteve specifike ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi, të cilat përveç shkëmbimit të njohurive dhe eksperiencave, do të sjellin rezultate të dukshme në sektorin e mjedisit, turizmit, punësimit etj.

Ky program mbështet gjithashtu në shkëmbimin e eksperiencës dhe të njohurive ndërmjet përfituesve, si dhe në përmirësimin e politikave publike mes autoriteteve kombëtare, rajonale dhe lokale në zonën e programit. Programi në fjalë mbulon një territor prej 11 970 km², me një popullsi rreth 749 257 banorë.

Alokimet e vitit 2016 për këtë program financohen nga një grant i BE-së, nëpërmjet instrumentit IPA II, me një vlerë prej 1 700 000 (një million e shtatëqind mijë) euro për të dyja vendet, por duke marrë parasysh edhe bashkëfinancimin kombëtar të dy shteteve (300000 treqindmijë) euro bashkërisht, buxheti i përgjithshëm i programit për vitin 2016 arrin vlerën 2 000 000 (dy milionë) euro.

Kontributi që do të japë BE-ja për zbatimin e përbashkët të programit Mal i Zi-Shqipëri, për periudhën 2014-2020, arrin vlerën 11 900 000 (njëmbëdhjetë milion e nëntëqind) euro për alokimet

e mëtejshme. Sjellim në vëmendje se dy marrëveshje të tjera financimi janë konkluduar ndërmjet palëve për të njëjtin program (për alokimet e viteve 2014 dhe 2015), të cilat janë ratifikuar dhe nga Kuvendi I Republikës së Shqipërisë (Ligji nr 31/2016).

Programi do të fokusohet në këto prioritetet tematike:

1. Nxitja e turizmit dhe e trashëgimisë kulturore dhe natyrore;
2. Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut;
3. Nxitja e punësimit, lëvizjes gjeografike të punonjësve dhe përfshirjes sociale e kulturore përtej kufirit.

Përfitues të këtij programi do të jenë zonat si më poshtë:

Në Mal të Zi: Andrijevice, Berane, Petnjica, Plavë, Gucia, Rozhajë, Podgoricë, Cetinje, Danilovgrad, Budva, Bar dhe Ulqin.

Në Shqipëri: Shkodra, Lezha, Rrethi i Tropojës.

Mali i Zi dhe Shqipëria do të bashkëpunojnë ngushtë për koordinimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të programit. Struktura institucionale e programit është e përbërë nga autoriteti kontraktues i programit (Mal i Zi), Komiteti i Përbashkët i Monitorimit, Sekretariati i Përbashkët Teknik, si dhe koordinatorët kombëtarë të fondeve IPA të të dyja vendeve përfituese

Në aspektin e teknikës legislative, marrëveshja, plotëson kërkesat formale të një marrëveshje.

Për zbatimin e saj do të jetë përgjegjëse Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, në cilësinë e koordinatores kombëtare e asistencës së BE-së për Shqipërinë.

Diskutimet në Komision :

Pas prezantimit të projektligjit dhe sqarimeve të nevojshme nga pala e ftuar, komisioni votoi në parim, nen për nen dhe në tërësi projektligjin.

Aspekti procedural i projektligjit

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Evropian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mal i Zi-Shqipëri, alokimet për vitin 2016” është në përputhje me parashikimet e ligjit 43/2016 “Për Marrëveshje ndërkombëtare.”

Dhe konkretisht nenit 18 pika 3 në të cilën thuhet “Aderimi/pranimi/miratimi i marrëveshjes ndërkombëtare bëhet nga Kuvendi. Projektligji, i shoqëruar me dokumentet e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, i kalon për aderim/pranim/miratim Kuvendit.”

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim Komisioni për Politikën e Jashtme shqyrtoi projektligjin në parim, dhe në tërësi, me gjithë anëtarët e pranishëm, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

KRYETARE

Mimi KODHELI